



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/112

Datë: 13/10/2020

Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 07. 10. 2020, bazuar në kushtet e krijuara si rezultat i pandemisë COVID-19, mori

VENDIM

Për ndryshim të nenit 5, paragr. 2 të Rregullores nr.2-475, datë 8.09. 2017, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës

Neni 5, paragrafi 2 i Rregullores bazike plotësohet me një pikë si vijim:

Neni 1

Konkursi për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm

1. Procedura e angazhimit bëhet në mënyre transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit publik.
2. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet për kategoritë si në vijim:
 - Në rastin e paraqitjes së fuqisë madhore (si tërmetet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste të cilat pengojnë palën, pandemitë, epidemitë e të ngjashme) kur pamundësohet organizimi i konkursit publik, lejohet angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm të cilët kanë qenë të kontraktuar sipas konkursit publik të vitit paraprak.

Neni 2

Pikët tjera të nenit 5, paragrafit 2 të Rregullores bazike, mbesin të pandryshuara.

Neni 3

Ndryshim plotësimi i nenit 5, paragrafit 2, është pjesë përbërëse e Rregullores nr.2-475, datë 8.09.2017, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës dhe do të zbatohet vetëm në rast të paraqitjes së situatave të fuqisë madhore të specifikuar si më sipër.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Dekanëve dhe sekretarëve të Fakulteteve,
3. Menaxhmentit dhe Sekretarit të UP-së dhe
4. Zyrës për çështje akademike.



Kryesues i Senatit

Naser Sahiti
Prof. Dr. Naser Sahiti, rektor



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 21475
Datë: 8/9/2017

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07. 09. 2017, bazuar në nenin 14, pika 3.4 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, miraton:

**RREGULLOREN E PROCEDURAVE VLERESUESE PËR ANGAZHIMIN E
BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"**

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave vlerësuese për angazhimin bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ligjëratave përkatësisht ushtrimeve si dhe provimeve, kollokviumeve, konsultimeve dhe mentorimeve sipas nevojës.

Neni 2

Baza ligjore

Ligji për Arsimin e Lartë dhe Statuti i Universitetit të Prishtinës.

Neni 3

Procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Procedurat për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm bazohen në nevojën e sigurimit të veprimtarisë së qëndrueshme të Universitetit në përputhje me obligimet e tij me theks të veçantë në aktivitetet si në vijim:

1. Aktivitetin mësimor (ligjërata, ushtrime);

2. Aktivitetin konsultativ;
3. Mbajtjen e provimeve në lëndët në të cilat angazhohen;
4. Mentorimi i temave në nivelin bachelor.

Neni 4

Periudha e angazhimit

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtë bëhet për një semestër përkatësisht për dy semestra të të njëjtit vit akademik.
2. Kontrata për angazhim lidhet prej datës 1 tetor deri me 15 janar, përkatësisht prej 16 shkurt deri më 30 qershor të vitit përkatës akademik.
3. I angazhuari ka për obligim që në kuadër të kontratës të mbajë provimet për të gjitha afatet brenda vitit përkatës akademik.
4. I angazhuari ka të drejtë të mentoroj kandidatët në nivelin bachelor me kusht që mbrojtja e temave të lëndëve të semestrit dimëror të përfundojë më së largu deri më 15 Prill kurse të semestrit veror më së largu deri më 30 Nëntor të vitit përkatës akademik.

Neni 5

Konkursi për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm

1. Procedura e angazhimit bëhet në mënyre transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit publik.
2. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet për kategoritë si në vijim:
 - Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune.
 - Personeli i cili në momentin e plotësimit të moshës mandatore të pensionit ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Prishtinës dhe nëse fakulteti ka nevojë për angazhimin e tyre. Angazhimi i kësaj kategorie të bashkëpunëtorëve bëhet deri në moshën e lejuar me akte të veçanta. Këshilli i fakultetit nxjerr vendimin për angazhimin e kësaj kategorie për vitin akademik përkatës.
 - Profesorët vizitorë nga vendet tjera të punësuar në Universitetet respektive (për një numër të caktuar të ligjëratave deri në një semestër), me vendim të Senatit.
3. Konkursi do të shpallet vetëm nëse brenda universitetit nuk ka personel akademik të mjaftueshëm brenda fushës përkatëse.
4. Konkursi për angazhim shpallet nga Senati me propozim të fakultetit, të bazuar në nevojat e tyre për ligjërata përkatësisht ushtrime.

5. Rektori në raste të veçanta, me një arsyetim të bazuar mund t'i propozojë senatit shpalljen e konkursit për angazhim të personelit në fakultetin e caktuar.
6. Konkursi duhet ti referohet kushteve të kësaj rregulloreje.
7. Konkursi duhet të shpallet në ueb faqen e Universitetit të Prishtinës. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e shpalljes.
8. Kandidatët të cilët aplikojnë duhet ti dorëzojnë të gjitha dokumentet brenda afatit të konkursit në kopje të fortë në fakultetin gjegjës, ndërsa të skanuara në adresën elektronike **punesimi.akademik@uni-pr.edu** dhe në adresën elektronike të dekanit të fakultetit.
9. Diplomat për gradat shkencore të fituara jashtë vendit do të merren në konsideratë vetëm nëse janë të nostrifikuara dhe të dorëzuara para mbylljes së konkursit.

Neni 6

Komisioni vlerësues

1. Brenda 7 ditëve pas hapjes së konkursit, dekani i fakultetit thërret mbledhjen e këshillit të fakultetit në të cilën merret vendimi për formimin e komisionit vlerësues.
2. Komisioni vlerësues propozohet në nivel të departamentit/ degës ose programit dhe aprovohen në këshillin e fakultetit.
3. Komisioni vlerësues është organ me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik, i cili përbëhet prej tre (3) anëtarëve.
4. Komisioni vlerësues përbëhet prej profesorëve në marrëdhënie të rregullt pune, anëtarë të departamentit përkatësisht degës ose programit përkatës.
5. Anëtari i komisionit vlerësues me thirrje me të lartë akademike me automatizëm është kryetar i komisionit. Nëse se paku dy nga anëtarët e komisionit kanë thirrje akademike të njëjtë, kryetar do të jetë anëtari më i vjetër në moshë.
6. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve nga departamenti në marrëdhënie të rregullt të punës, anëtar të komisionit vlerësues mund të jenë edhe personat e pensionuar, të cilët janë të angazhuar në departamentin përkatës.
7. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve si në pikën 5 dhe 6 të këtij neni, në përbërje të komisionit vlerësues mund të emërohen edhe profesorë nga departamentet tjera, por në këtë rast kryetari i komisionit duhet të jetë nga radha e profesorëve të departamentit për të cilin janë duke u vlerësuar aplikacionet.
8. Administrata e fakultetit duhet t'ia ofron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm komisionit vlerësues.
9. Kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që të thërras mbledhjen e komisionit dhe në koordinim me anëtarët e tjerë të hartoj raportin e vlerësimit.

10. Komisioni, gjatë hartimit të raportit vlerësues, ka për obligim zbatimin e kushteve të konkursit dhe të kësaj rregulloreje.
11. Komisioni vlerësues ka për obligim shqyrtimin e aplikacionit të të gjithë kandidatëve të paraqitur në lëndën përkatëse.
12. Komisioni vlerësues ka për obligim që në raportin vlerësues t'i prezantoj të gjitha faktet relevante (në mënyrë tabelare) për të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs për lëndën përkatëse.
13. Komisioni vlerësues mbanë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit.

Neni 7

Kushtet e angazhimit

1. Personat e angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm nuk marrin thirrje akademike. Angazhimi i tyre bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara në vazhdim të kësaj rregullore.
2. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata kandidatët duhet ti plotësojnë këto kushte:
 - 2.1. Të ketë gradën shkencore Doktor i shkencave nga lëmia përkatëse (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të). Kandidatët të cilët krahas thirrjes Doktor i shkencave kanë edhe thirrje akademike të ligjëruesit ose profesorit, të fituar në një nga universitetet publike, kanë përparësi në përzgjedhje.
 - 2.2. Të ketë së paku 1 publikim në revistat shkencore ndërkombëtare (në Fakultetin e Arteve së paku 1 vepër artistike të rangut ndërkombëtar në fushën përkatëse) në përputhje me kriteret e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe rregullativën përkatëse.
 - 2.3. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata në Mjekësi, në lëndët klinike, kandidati duhet të dëshmoj që ka së paku 3 vite përvojë pune aktive profesionale në mjekësinë terciare.
3. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:
 - 3.1. Të kenë të përfunduar studimet master ose ekuivalent me të në lëmin përkatëse.
 - 3.2. Të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.
 - 3.3. Të jetë jo më i vjetër 30 vjet (respektivisht jo më i vjetër se 35 vjet në Fakultetin e Mjekësisë) kur angazhohet për herë të parë. Përjashtimisht, kandidatët mund të angazhohen për ushtrime deri në moshën 40 vjeçare nëse kanë gradën Dr. Sc. dhe

që plotëson kriterin e përcaktuar sipas alinesë 3.2 të këtij neni. Përparësi në angazhim kanë kandidatët me gradën doktor i shkencave.

- 3.4. Në Fakultetin e Mjekësisë (në lëndët klinike), në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinës (në lëndët klinike të veterinarisë) dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (në lëndët laboratorike¹) kandidati duhet të dëshmojë që ka së paku 3 vite përvojë pune profesionale në fushën përkatëse kurse në Fakultetin e Mjekësisë angazhimi bëhet duke marrë parasysh edhe Ligjin e Shëndetësisë.
- 3.5. Të ketë të përfunduar specializimin ose të jetë së paku në vitin e tretë të specializimit për lëndët klinike (në rastin e Fakultetit të Mjekësisë).
4. Në rastin kur më shumë se një kandidat për pozitën përkatëse i plotëson kriteret e pikës 2 përkatësisht 3 të këtij neni, përzgjedhja do të bëhet sipas këtij prioriteti:
 - kandidati me përvojë më të gjatë në fushën përkatëse,
 - kandidati i gjinisë femërore,
 - në rastet tjera mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues dhënia e përparësisë kandidatit të caktuar.
5. Nëse asnjëri nga kandidatet e paraqitur nuk i plotëson të gjitha kriteret e pikës 2 përkatësisht 3 të këtij neni, apo nëse nuk konkurren asnjë kandidat, konkursi rishpallet për pozitën respektive. Konkursi i përsëritur do të jetë i hapur në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike.
6. Nëse edhe pas rishpalljes së konkursit, asnjëri prej kandidatëve nuk i plotëson të gjitha kriteret e paragrafit 2 të këtij neni atëherë kandidatët do të angazhohen duke aplikuar përparësinë si në vijim:
 - 6.1 Kandidati me gradën shkencore më të lartë
 - 6.2 Në rastin e kushteve tjera të barabarta, përparësi ka kandidati me përvojë më të gjatë në pozitën përkatëse, pastaj kandidati i gjinisë femërore kurse në rastet tjera mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues dhënia e përparësisë kandidatit të caktuar.
7. Nëse edhe pas rishpalljes së konkursit, asnjëri prej kandidatëve nuk i plotëson të gjitha kriteret e paragrafit 3 të këtij neni atëherë kandidatët do të angazhohen duke aplikuar përparësinë si në vijim:
 - 7.1. Kandidati që plotëson numrin më të madh të kritereve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni;

¹ Lista e lëndëve klinike të Fakultetit të Mjekësisë, lëndëve klinike të fushës së veterinarisë dhe lëndëve laboratorike të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike është e publikuar në web faqen e Universitetit të Prishtinës dhe të fakulteteve përkatëse

7.2. Në rastin e kushteve tjera të barabarta, përparësi ka kandidati me përvojë më të gjatë në pozitën përkatëse, pastaj kandidati i gjinisë femërore kurse në rastet tjera mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues dhënia e përparësisë kandidatit të caktuar.

8. Në mungesë të kandidatëve me gradën doktorit të shkencave (Dr. Sc.) dhe nëse brenda njësisë akademike nuk mund të sigurohet kandidati me gradën e magjistrisë (Mr. Sc) ose masterit (MA) i cili do të mund të angazhohej për mbajtjen e ligjëratave në lëndën e caktuar në përputhje me Statutin e Universitetit të Prishtinës, për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjëratë në nivelin bachelor mund të angazhohet kandidati me gradën Mr.Sc. ose MA duke i dhënë përparësi kandidatit që ka të regjistruara studimet e doktoratës. Për të njëjtin këshilli i fakultetit nxjerr vendim për t'ia besuar lëndën nën përkujdesjen e një profesori në marrëdhënie të rregullt pune në fushën përkatëse.
9. Kandidatët me thirrje më të ultë se master ose ekuivalente me të, nuk mund të angazhohen si bashkëpunëtor të jashtëm në Universitetin e Prishtinës.
10. Në Universitet të Prishtinës nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune apo honorar në institucione publike apo private me pagë primare apo sekondare.
11. Në Universitet të Prishtinës, nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (departament/degë apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin prind- fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).

Neni 8

Afatet e vlerësimit dhe marrja e vendimit për angazhim

1. Komisioni i vlerësimit në afat prej 5 ditëve² pas mbylljes së konkursit përgatit raportin vlerësues të cilin këshilli i fakultetit e shqyrton në afat prej 10 ditëve pas mbylljes së konkursit.
2. Vendimi i këshillit të fakultetit së bashku me raportin e komisionit vlerësues sipas pikës 12 të nenit 6 të kësaj rregulloreje publikohet në ueb faqen e fakultetit ditën e shqyrtimit në këshill të fakultetit, në kohëzgjatje prej së paku 5 ditëve.
3. Bazuar në vendimin e këshillit të fakultetit, dekani nxjerr vendim për angazhimin e kandidatit përkatës.

² Të gjitha afatet në këtë rregullore nënkuptojnë ditët kalendarike

Neni 9

E drejta e ankesës

1. Fakultetet obligohen që të themelojnë komision për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
2. Komisioni i ankesave i përbërë prej 3 ose 5 anëtarëve emërohet nga këshilli i fakultetit dhe në përbërjen e tij nuk mund të jenë strukturat udhëheqëse të fakultetit.
3. Kandidatet e pakënaqur kanë të drejtë ankese pranë komisionit për ankesa në fakultetin përkatës, brenda 8 ditëve nga dita e marrjes së vendimit në këshill të fakultetit.
4. Komisioni i ankesave më së largu 3 ditë pas përfundimit të afatit të ankesave përpilon raportin dhe propozimin përkatës të njëjtën ditë e dorëzon në këshill të fakultetit. Këshilli i fakultetit në afat prej 3 ditëve nga marrja e raportit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendos për miratim ose refuzim të tij.
5. Shqyrtimi i ankesave dhe marrja e vendimit përkatës në këshillin e fakultetit është vendim përfundimtar në nivel të universitetit.
6. Dekani i fakultetit, pas shqyrtimit të ankesave eventuale, në mbledhjen e parë të Senatit i njofton Senatorët me listën e kandidatëve të angazhuar.
7. Dekani i fakultetit, në bazë të nenit 72, paragrafi 2 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe vendimit nr. 2/58, dt. 11. 07. 2017 të Këshillit Drejtues autorizohet ta përfaqësojë universitetin në emër të fakultetit lidhur me vendimet e marra në përputhje me këtë rregullore.

Neni 10

Nënshkrimi i kontratës për angazhim

Pas njoftimit të Senatit nga ana e dekanit përkatës me listën e kandidatëve të angazhuar, Rektori nënshkruan kontratat e të angazhuarve.

Neni 11

Të drejtat dhe obligimet

1. Kandidatit të angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe kompensimin e përvojës së punës.
2. Angazhimi sipas kësaj rregulloreje nuk nënkupton themelim të marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
3. Në rast të konkurrimit për themelim të marrëdhënies së rregullt të punës aplikohen dispozitat e Statutit të UP-së për pozitën përkatëse.

4. Kandidatët e angazhuar bartin përgjegjësi ligjore për mënyrën e shfrytëzimit të aseteve të Universitetit të Prishtinës.


Neni 12

Dispozitat kalimtare

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje hyjnë në fuqi nga dita e miratimit në Senat.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohen të gjitha aktet nënligjore me të cilat është rregulluar çështja e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Kryesues i Senatit të UP-së "Hasan Prishtina"

Prof. Dr. Marjan DEMA



Rektor i UP-së